



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1055 Prot.

Tiranë, më datë 31.08.2022

VENDIM
Nr. 443, datë 31.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi i Kishës së Shën Mëhillit” Voskopojë, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues DRTK Korçë;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

